



REPUBLIC OF KOSOVO GOVERNMENT	MINISTRY OF EDUCATION, SCIENCE, TECHNOLOGY AND INNOVATION
MINISTARSTVO OBRAZOVANJA, NAUKE I TEHNOLOGIJE	MINISTERSTVO OBRAZOVANJA, NAUKE I TEHNOLOGIJE
MINISTRIA E ARSIMIT, SHKENCËS, TEKHNOLOGjisë DHE INOVACIONIT	MINISTRIES OF EDUCATION, SCIENCE, TECHNOLOGY AND INNOVATION
SEKTOR TARIKES-SEKTOR ARHIVE-ARCHIVE SECTOR	SEKTOR TARIKES-SEKTOR ARHIVE-ARCHIVE SECTOR
Nr. Prot. Broj Prot: Prot. No: Data: Datum: Date:	01B 3169 Prishtina / e 03.12.2021
Njësia Org. Org. Jedinica Org. Unit Nr. i faqeve Br. stranica No. pages	

Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria -Vlada-Government

Ministria e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit
Ministarstvo Obrazovanja, Nauke, Tehnologije i Inovacije - Ministry of Education, Science,
Technology and Innovation

Kabineti i Ministrat/Kabinet Ministra/Cabinet of the Minister

Numër: 01B/347
Datë: 03.12.2021

Ministria e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit, në mbështetje të neneve 8, 10 dhe 11 të Ligi nr. 06 / L-113 për Organizimin dhe Funksionimin e Administratës Shtetërore dhe të Agjencive të Pavarura (Gazeta zyrtare nr. 7/01 mars 2019), neni 8 paragrafi 1 nënparagrafi 1.4, shtojca 1 paragrafi 7 i Rregullores (QRK) nr. 02/2021 përfundimtare e përgjegjësisë administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrite të datës 30.03.2021, nxjerrë këtë:

V E N D I M

Për themelimin e Komiteti Këshillues për Edukimin në Fëmijërinë e Hershme

1. Themelohet Komiteti Këshillues për Edukimin në Fëmijërinë e Hershme (KKEFH) si trup këshillëdhënës i Ministrisë së Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit (MASHTI), i përbërë nga akterë relevant në fushën e edukimit në fëmijërinë e hershme (EFH).
2. Detyrat specifike të KKEFH janë si në vijim:
 - 2.1. Avokon përfundimtare e EFH;
 - 2.2. Shërben si mekanizëm i ndarjes së informatave në fushën e EFH;
 - 2.3. Këshillon përfundimtare e identifikuar në fushën e EFH dhe përfundimtare e menjëhershme dhe afatgjatë;
 - 2.4. Analizon, identifikon dhe jep rekomandime mbi qasjet ekzistuese dhe mbi nevojën përfundimtare së konsideratë qasje të reja;
 - 2.5. Identifikon mundësi të hulumtimit në fushën e EFH;
 - 2.6. Ofron rekomandime dhe këshilla mbi zhvillimin strategjik të EFH;

- 2.7. Oftron rekomandime dhe avokon për gjithëpërfshirjen në të gjitha aspektet (gjinor, etnik, aftësive të kufizuara, gjendjes ekonomike) në këtë nivel;
 - 2.8. Jep rekomandime për alokimin e buxhetit dhe procesin e investimeve në këtë nivel bazuar në nevojat aktuale;
 - 2.9. Oftron mundësi për ndërlidhje dhe shkëmbim me organizatat/ekspertët lokal dhe ndërkombëtar për kontributin në zhvillimin e programeve për këtë nivel.
3. Emërohen anëtarët e Komiteti Këshillues për Edukimin në Fëmijërinë e Hershme me këtë përbërje:
 - 3.1. Një (1) përfaqësues nga Divizioni për Edukim të Hershëm dhe Parashkollor në MASHTI
 - 3.2. Një (1) përfaqësues nga Kabineti i MASHTI
 - 3.3. Një (1) përfaqësues nga Zyra e Kryeministrit
 - 3.4. Një (1) përfaqësues nga Avokati i Popullit
 - 3.5. Një (1) përfaqësues nga Ministria e Shëndetësisë
 - 3.6. Një (1) përfaqësues nga Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve
 - 3.7. Pesë (5) përfaqësues nga Fakultetet e Edukimit (FE) të universiteteve publike
 - 3.8. Një (1) përfaqësues nga Kolegjumi i Institucioneve Parashkollore (KIP)
 - 3.9. Një (1) përfaqësues nga Asociacioni i Institucioneve Shkollore Private (AISHP)
 - 3.10. Një (1) përfaqësues nga Instituti Pedagogjik i Kosovës (IPK)
 - 3.11. Një (1) përfaqësues nga Kolegjumi i Drejtoreve Komunale për Arsim (DKA)
 - 3.12. Një (1) përfaqësues nga Kolegjumi për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale (KSHMS)
 - 3.13. Një (1) përfaqësues nga Këshilli i Prindërve (KP)
 - 3.14. Një (1) përfaqësues nga Qendra për Shërbime Humane dhe Zhvillim (QSHHZH)
 - 3.15. Një (1) përfaqësues nga UNICEF
 - 3.16. Një (1) përfaqësues nga Save the Children (SC)
 - 3.17. Një (1) përfaqësues nga Caritasi zviceran
 - 3.18. Një (1) përfaqësues nga Forumi për aftësinë e kufizuar
 - 3.19. Një (1) përfaqësues nga Koalicioni i OJQ-ve për Mbrojtjen e Fëmijëve (KOMF)
 - 3.20. Një (1) përfaqësues nga Banka Botërore (BB)
 - 3.21. Një (1) përfaqësues nga Agjencja Amerikane për Zhvillim Ndërkombëtar (USAID)
 - 3.22. Një (1) përfaqësues nga Zyra e Bashkimit Evropian (BE).
 4. Angazhimi i anëtarëve në KKEFH është vullnetar dhe KKEFH ka vetëm funksion këshillues.
 5. Aprovohen termat e referencës së Komiteti Këshillues për Edukimin në Fëmijërinë e Hershme të bashkangjitura në këtë vendim.
 6. Vendimi hyn në fuqi me nënshkrimin e tij.

A r s y e t i m

Duke u mbështetur në dispozitat e shënuara më lartë, në funksion të zhvillimit të Edukimin në Fëmijërinë e Hershme dhe përfshirjes së akterëve të fushës në zhvillim të politikave në këtë fushë dhe procesin e këshillimit për Ministrinë e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit si dhe themelimit të këtij komiteti, u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

Vendimi u dërgohet:

1. Të lartpërmendurve;
2. Kabinetit të Ministres / MASHTI;
3. Zyrës së SP/MASHTI;
4. Arkivit/MASHTI.



Termat e referencës

KOMITETI KËSHILLUES PËR EDUKIMIN NË FËMIJËRINË E HERSHME

Komiteti Këshillues për Edukimin në Fëmijërinë e Hershme (KKEFH) është trup këshillëdhënës i Ministrisë së Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit (MASHTI), i përbërë nga akterë relevant të përfshirë në fushën e edukimit në fëmijërinë e hershme (EFH).

QËLLIMI

KKEFH është krijuar me aprovim të Ministres dhe ka për qëllim ofrimin e një forumi gjithëpërfshirës dhe ndërsektorial të akterëve relevantë të EFH për t'a lehtesar komunikimin dhe bashkëpunimin ndërmjet palëve të interesit dhe për t'a ndihmuar MASHTI-n në zhvillimin dhe implementimin e duhur të politikave në EFH.

PËRGJEGJËSITË E KKEFH

Detyrat specifike të KKEFH janë si në vijim:

- Avokon për rëndësinë e EFH;
- Shërben si mekanizëm i ndarjes së informatave në fushën e EFH;
- Këshillon për prioritetet e identikuara në fushën e EFH dhe për intervenime të menjëhershme dhe afatgjatë;
- Analizon, identifikon dhe jep rekomandime mbi qasjet ekzistuese dhe mbi nevojën për të marrë në konsideratë qasje të reja;
- Identifikon mundësi të hulumtimit në fushën e EFH;
- Ofron rekomandime dhe këshilla mbi zhvillimin strategjik të EFH;
- Ofron rekomandime dhe avokon për gjithëpërfshirjen në të gjitha aspektet (gjinor, etnik, aftësive të kufizuara, gjendjes ekonomike) në këtë nivel;
- Jep rekomandime për alokimin e buxhetit dhe procesin e investimeve në këtë nivel bazuar në nevojat aktuale;
- Ofron mundësi për ndërlidhje dhe shkëmbim me organizatat/ekspertët lokal dhe ndërkombëtar për kontributin në zhvillimin e programeve për këtë nivel.

Kontributi në KKEFH është vullnetar dhe KKEFH është trup këshillues dhe jo ekzekutiv.

ANËTARËT E KKEFH:

Anëtarët e KKEFH janë përfaqësues nga institucionet e shënuara më poshtë:

- Një (1) përfaqësues nga Divizioni për Edukim të Hershëm dhe Parashkollar në MASHTI
- Një (1) përfaqësues nga Kabineti i MASHTI

- Një (1) përfaqësues nga Zyra e Kryeministrat
- Një (1) përfaqësues nga Avokati i Popullit
- Një (1) përfaqësues nga Ministria e Shëndetësisë
- Një (1) përfaqësues nga Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve
- Pesë (5) përfaqësues nga Fakultetet e Edukimit (FE) të universiteteve publike
- Një (1) përfaqësues nga Kolegjumi i Institucioneve Parashkollore (KIP)
- Një (1) përfaqësues nga Asociacioni i Institucioneve Shkollore Private (AISHP)
- Një (1) përfaqësues nga Instituti Pedagogjik i Kosovës (IPK)
- Një (1) përfaqësues nga Kolegjumi i Drejtoreve Komunale për Arsim (DKA)
- Një (1) përfaqësues nga Kolegjumi për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale (KSHMS)
- Një (1) përfaqësues nga Këshilli i Prindërve (KP)
- Një (1) përfaqësues nga Qendra për Shërbime Humane dhe Zhvillim (QSHHZH)
- Një (1) përfaqësues nga UNICEF
- Një (1) përfaqësues nga Save the Children (SC)
- Një (1) përfaqësues nga Caritas zviceran
- Një (1) përfaqësues nga Forumi për aftësinë e kufizuar
- Një (1) përfaqësues nga Koalicioni i OJQ-ve për Mbrojtjen e Fëmijëve (KOMF)
- Një (1) përfaqësues nga Banka Botërore (BB)
- Një (1) përfaqësues nga Agjencia Amerikane për Zhvillim Ndërkombëtar (USAID)
- Një (1) përfaqësues nga Zyra e Bashkimit Evropian (BE).

Varësisht nga temat dhe çështjet e ngritura në takimet e komitetit mund të ftohen edhe përfaqësues të tjerë të institucioneve dhe organizatave.

UDHËHEQËSIA DHE KOORDINIMI I KKEFH

KKEFH udhëhiqet nga Zëvendsministri/ja i/e MASHTI, ndërsa kordinimi dhe organizimi bëhet nga Divizioni për Edukim të Hershëm dhe Parashkollar në kuadër të MASHTI.

Përgjegjësítë e kryesueses/it	Përgjegjësítë e kordinatores/it
<ul style="list-style-type: none"> • Të caktojë agjendën • Udhëheq diskutimin 	<ul style="list-style-type: none"> • Kordinon grupin dhe takimet • Fton pjesëmarrësit

Përgjegjësítë e anëtarëve

Anëtarët duhet t'u përgjigjen çdo thirrje edhe në rast së nuk mund të marrin pjesë. Anëtarët duhet të jenë pjesëmarrës aktiv dhe të dërgojnë/ofrojnë reagime në kohën e përcaktuar nga KKEFH.

Mbajtja e minutave të takimit ndodhë në rrotacion dhe përcaktohet brenda grupit.

PROCEDURAT OPERACIONALE

Takime

Takimet e KKEFH mbahen çdo 3 muaj. Sipas nevojës mund të thirren takime të tjera jashtë këtij formati dhe për diskutim të temave specifike.

Ftesa dërgohet së paku një (1) javë përpara me një agjendë.

Vendimmarrja në KKEFH

Do të funksionojë përmes votimit ku vota mbi 50% e anëtarëve prezent do të hyjë ne favor.

Raportimi

Çdo informacion nga takimi duhet të ndahet me KKEFH dhe Ministren e MASHTI me shkrim.

RISHIKIMI I TOR DHE MANDATIT

MASHTI ka për qëllim shfrytëzimin e këtij komiteti për të siguruar që zhvillimi i EFH mbetet relevante dhe i adreson nevojat e nivelit. Për këtë, MASHTI do të bëjë rishikimin e mandatit të KKEFH dhe TOR çdo dy (2) vjet.